

BASHKIA KOLONJË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr.2108 prot
25.06.2019

Data:

Për: [BOE “ Arkonstudio Shpk ” L42019004I dhe “ED KONSTRUKSION Shpk ” K61625001I]

Adresa: Arkonstudio Shpk Tiranë Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Frosina Plaku, Pallati nr.21, Shkalla A, Apartamenti nr.5,Kati III – te dhe ED KONSTRUKSION Shpk Tiranë Njësia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndertesha 6, Hyrja 10, Apartamenti 6.

Procedura e prokurimit: “E HAPUR”, “PUNË”,prokurim me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës: **REF-19148-04-23-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Rikonstrukion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë , Bashkia Kolonjë.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.BOE “ Arkonstudio Shpk ” dhe “ED KONSTRUKSION Shpk ”

Emri i plotë i shoqërisë

L42019004I **K61625001I**

numri i NIPT-it

Vlera **58,968,555** (Pesëdhjetëetëmilionenëntëqindëgjashtëdhjetëetëmijëepesëqindëpesë dhjetëepesë) **Lekë pa Tvsh**

(me numra dhe fjalë)

2.Operatori Ekonomik **ELDA – VL SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

K67106202W

numri i NIPT-it

Vlera **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike .**

(me numra dhe fjalë)

3.Operatori Ekonomik **Shendelli Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

K07924803N

numri i NIPT-it

Vlera **48,264,134** (Dyzetëetëmilionedyqindëgjashtëdhjetëekatërmijëe njëqindetridhjetëekatër) **lekë pa Tvsh**

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomik **ELDA – VL SHPK**
Emri i plotë i shoqërisë

K67106202W
numri i NIPT-it

2.Operatori Ekonomik **Shendelli Shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

K07924803N
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **ELDA – VL SHPK** **K67106202W**

Çmimi total i ofertës Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike .

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **ELDA – VL SHPK** me numer **NIUS K67106202W** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike si dhe kishte mungesë të plotë në të gjitha dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit . Operatori ekonomik ka dorezuar vetem ekstrakt te thjeshte.

Mungesa e ofertës ekonomike dhe dokumentacionit u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të 46, pika 1 nenit 53, pika 3 Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 66 , Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe fakteve të mësipërme shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurën e prokurimit e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomikë “**ELDA – VL Shpk**”, pasi nuk plotëson kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**” me **NIUS K07924803N**

1. Nga verifikimi i dokumentacionit të “Formularit të Ofertës” sipas shtojcës 1, rezulton se **vlera pa tvsh e ofertës ekonomike të ofruar** , nuk përputhet me vlerën **pa tvsh** të përlogaritur në **preventivin** e paraqitur nga operatori ekonomik .

Kjo konstatohet për faktin se vlera në preventivin e paraqitur konkretisht **shuma 1** në vlerën **46,190,801 lekë pa tvsh** plus **pajisjet (C-2,C-5,C-7)** në vlerën **2,488,000 lekë** duhet të jetë **48.678.801 lekë pa tvsh** , ndërsa vlera e ofertës ekonomike të ofruar sipas shtojcës 1 është **48.264.134 lekë pa tvsh**.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli Shpk”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vërehet se preventivi i ofertës është paraqitur me gabime aritmetike.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike për gabime aritmetike, konkretisht preventivit janë bërë korigjimet përkatëse duke mbledhur nëntotale të shënuara në preventiv, nga ku rezultoi se vlera e shumës të zërit **C-4 SISTEMI I NGROHJES** të paraqitur në preventiv nga ofertuesi është **1,269,800 lekë pa tvsh**, ndërsa pas korigjimit vlera e shumës të zërit **C-4 SISTEMI I NGROHJES** rezulton të jetë **3,149,300 lekë pa tvsh**.

Si rezultat i korigjimeve të bëra **shuma pa pajisje C (C-1, C-3, C-4, C-6)** duhet të jetë në vlerën totale **7,954,084 lekë pa tvsh** dhe jo **6,074,584 lekë pa tvsh**.

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur dhe nga përlllogaritjet e kryera, rezulton se, oferta e paraqitur, pas korigjimit të veprimeve duhet të jetë në vlerën totale pa tvsh **50,595,891 lekë pa tvsh** dhe jo **48,264,134 lekë pa tvsh**, siç është shënuar në formularin e ofertës të paraqitur nga ofertuesi.

Referuar nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht:

“Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

Nga veprimet aritmetike të kryera të të gjithë preventivit të paraqitur, rezulton se oferta e operatorit ekonomik ka gabime aritmetike, pas mbledhjes së nëntotaleve të përcaktuara në preventiv, gabime këto që tejkalojnë vlerën **2%** të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar nga ky i fundit, konkretisht **4.8 %**.

Në këto kushte, bazuar në përcaktimin ligjor si më sipër cituar, meqenëse gabimet janë më të larta se 2 % e vlerës së ofruar, oferta ekonomike e operatorit ekonomik **“Shendelli Shpk”** refuzohet menjëherë.

2. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.2** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Liçenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të kategorive dhe niveleve:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë.
2. NP – 2 B Ndërtime civile dhe industriale.
3. NP– 3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje dhe fasada
4. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve
2. NS- 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxantë, mirembajtja e tyre
3. NS-4 B Punime rifiniture dhe të lidhura me to,...
4. NS-8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike, dhe druri
5. NS-9 A Punime strukturore special
6. NS- 12 A Impiante teknologjike, termik dhe kondicionimit
7. NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj

8. *NS-18 A Punime topogjeodezike*

9. *NS- 19 A Sistemet kunder zhurmes per infrastructure*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ka paraqitur Licencen **NZ.3580/17**, lëshuar nga ministria e infrastrukturës dhe energjisë, për operatorin ekonomik “**Shendelli**” sh.p.k , regjistruar që nga data 20.05.2019 . Në këtë licencë profesionale, konstatohet se operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, nuk është i licencuar sipas klasifikimit në kategorinë **NS- 19 A Sistemet kundra zhurmës për infrastrukture** sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Sa më sipër, operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, nuk disponon kategorinë e licencës për kryerjen e punimeve , duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit .

3. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa a** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:

1) Arkitekt	1 (një)
2) Inxhinier Ndertimi	1 (një)
3) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
4) Inxhinier Elektrik	1 (një)
5) Inxhinier Mekanik	1 (një)
6) Inxhinier Topograf	1 (një)
7) Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Maj 2018-Prill 2019** .

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për dy punonjës inxhinier mjedisi konkretisht për znj.S.T e cila nuk figuron si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe znj.S.J e cila nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Maj 2018-Prill 2019 vërtetuar nga kontrata e punës e cila është lidhur në date 20.05.2019 midis palëve por dhe nga verifikimi i deklaratave të dorëzuara nga operatori ekonomik sipas "**Listëpagesave të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi**" për periudhën **Maj 2018 deri Dhjetor 2019 dhe Janar 2019 deri Prill 2019**.

Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për inxhinierin e mjedisit ,duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit .

4. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa b** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (një) Auditues energjie ,(i pajisur me “Çertifikatë për auditimin e energjisë)
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen

ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për **1 (një) punonjes** i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit .

5. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3 germa d kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et ekonomik duhet të kenë të punësuar si staf teknik 45 (**Dyzetëepesë**) punonjës të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë nga të cilët të jenë:*

NR	EMERTIMI	
1	<i>Inxhinier elektrik grupi v</i>	<i>(2 person)</i>
2	<i>Teknik Ndertimi</i>	<i>(2 person)</i>
3	<i>Elektracist</i>	<i>(4 persona)</i>
4	<i>Hidraulik</i>	<i>(4 persona)</i>
5	<i>Karpentier</i>	<i>(5 persona)</i>
6	<i>Hekurthyes</i>	<i>(5 persona)</i>
7	<i>Murator</i>	<i>(5 persona)</i>
8	<i>Shtrues pllakash</i>	<i>(5 persona)</i>
9	<i>Bojaxhi</i>	<i>(5 persona)</i>
10	<i>Saldator</i>	<i>(2 persona)</i>
11	<i>Specialist punime druri</i>	<i>(2 persona)</i>
12	<i>Montator</i>	<i>(1 person)</i>
13	<i>Manovratorë</i>	<i>(3 persona)</i>

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës*
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë.*
- Për manovratorët të paraqitet edhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë e lëshuar nga DPSHTRR .*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “**Shendelli Shpk**”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe kualifikues për:

2 (dy) punonjës Inxhinier elektrik grupi v , nga 2 punonjës të kërkuar ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe kualifikues vetëm për 1 punonjës,

2 (dy) punonjës Shtrues pllakash ,nga 5 punonjës të kërkuar ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe kualifikues vetëm për 3 punonjës ,

1 (një) punonjës Bojaxhi, nga 5 punonjës të kërkuar ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe kualifikues vetëm për 4 punonjës , duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit .

6. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa g** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike duhet të paraqesin dëshmi nga administrata tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën 80 (Tetëdhjetë) punonjës me kohë të plotë pune për periudhën **Maj 2018-Prill 2019**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Maj 2018-Prill 2019**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2018-Prill 2019**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **“Shendelli Shpk”**, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ka paraqitur **deklaratat "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi"** sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2018 deri Dhjetor 2019 dhe Janar 2019 deri Prill 2019**, ku rezultoi se :

Nr	Periudha	Numri i punonjësve kohë të plotë pune
1	Maj 2018	27
2	Qershor 2018	44
3	Korrik 2018	45
4	Gusht 2018	50
5	Shtator 2018	45
6	Tetor 2018	45
7	Nëntor 2018	46
8	Dhjetor 2018	46
9	Janar 2019	54
10	Shkurt 2019	54
11	Mars 2019	53
12	Prill 2019	50
	Totali	559
	Numri mesatar	46.6

Rezulton se, nga përlllogaritja e kryer, referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, që operatori/et ekonomike duhet të paraqesin dëshmi nga administrata tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën **80 (Tetëdhjetë) punonjës me kohë të plotë pune** për periudhën **Maj 2018 - Prill 2019**, operatori ekonomik **“Shendelli Shpk”**, nuk e ka përmbushur këtë kriter.

Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik **“Shendelli Shpk”** ka paraqitur një mesatare prej **46.6** punonjësish me kohë të plotë pune nga **80** të kërkuar për periudhën **Maj 2018 - Prill 2019**, duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit .

7.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.4 germa b,c** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

b.Operatori/et ekonomik për materialet

- Kollë- Pllaka- Llaçra- Polisterol- Kartonxhes

për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si:Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **Shendelli Shpk**,konkretisht për kontratën e furnizimit datë.06.08.2018 lidhur midis paleve shoqëria **D..... sh.a** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim Llaçra,Tulla,Bojra ,Inerte, Gips, Kartonxhes,Pllaka, Materiale hidroizolimi,rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar për materialet e ndërtimit Polisterol,Kartonxhes,pasi mungojnë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike.

c.Operatori/et ekonomik për materialet

- *Dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *Dyer të brëndeshme druri me xham të temperuar*
- *Ndriçues FL-(4x18)w IP-40*
- *Ndriçues FL-(1X18)W (pllafor)*
- *Ndriçues FL-(2X36)W IP-40*
- *Ndriçues evakuimi me llampe 1x11w;IP- 40*
- *Ndriçues tip plafoniere emergjence 1x18w;IP-65*

për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si:Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **Shendelli Shpk**,konkretisht, për kontratën e furnizimit datë.06.08.2016 lidhur midis paleve shoqëria **I A** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim dyer dritare druri dhe alumini, rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,pasi mungojnë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike.

Për kontratën e furnizimit datë.09.08.2018 lidhur midis paleve shoqëria **S E shpk** dhe shoqëria

Shendelli Shpk me objekt furnizim materiale elektrike të të gjitha llojeve, rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar, specifikimet teknike nuk janë në gjuhën shqipe, janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik, nuk ka dorëzuar dokumentacion kualifikues për plotësimin e pikës **2.3.4 germa b,c**, duke mos plotësuar kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të 46, pika 1 nenit 53, pika 3 Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 66, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe fakteve të mësipërme shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurën e prokurimit e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomikë “**Shendelli Shpk**”, pasi nuk plotëson kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *BOE “ Arkonstudio Shpk ” L42019004I dhe “ED KONSTRUKSION Shpk ” K61625001I]* me adresë: *Arkonstudio Shpk Tiranë Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Frosina Plaku, Pallati nr.21, Shkalla A, Apartamenti nr.5, Kati III – te dhe ED KONSTRUKSION Shpk Tiranë Njësia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndertesë 6, Hyrja 10, Apartamenti 6*. se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **58,968,555 (Pesëdhjetëtetëmilionenëntëqindëgjashtëdhjetë tetëmijë pesëqindëpesëdhjetëpesë) Lekë pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri	Bashkisë Kolonjë
Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, por jo me vone se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë :17.06.2019**

Ankesa: **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIA STEFO